



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 125 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01/23

Data/Datumi/Date 30 / 08 / 2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës Rahovec, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.08.2023, merr këtë:

## V E N D I M

### Për këmbimin e pronës komunale me pronën private

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, Nr. 02/1064/23, i datës 8.8.2023 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur *Qytet*, zona kadastrale Rahovec, parcela me numër P-71510057-01313-1 me sipërfaqe prej 110m<sup>2</sup> (njëqind e dhjetë metra katror), e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 910m<sup>2</sup> (nëntëqind e dhjetë metra katror), parcela me numër P-71510057-01313-2, me sipërfaqe prej 137 m<sup>2</sup> (njëqind e tridhjetë e shtatë metra katror), e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 200 m<sup>2</sup> (dyqind metra katror), parcela me numër P-71510057-01313-4, me sipërfaqe të përgjithshme prej 71m<sup>2</sup> (shtatëdhjetë e një metra katror) dhe parcela me numër P-71510057-01313-5, në sipërfaqe prej 128 m<sup>2</sup> (njëqind e njëzet e tetë metra katror), e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 271 m<sup>2</sup> (dyqind e shtatëdhjetë e një metra katror), sipas Certifikatës së pronësisë pronë e P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.DREJ.PËR KULTURË, I JEPET në bashkëposedim Hajrullah (Bahtijar) Dulës, Tasim (Bahtjar) Dulës dhe Ysnije (Sefer) Dulës nga Rahoveci, ndërsa parcela sipas Certifikatës së pronësisë P-71510057-01313-3, në bashkëposedim të Hajrullah (Bahtijar) Dulës, Tasim (Bahtjar) Dulës dhe Ysnije (Sefer) Dulës nga Rahoveci, me sipërfaqe prej 446m<sup>2</sup> (katërqind e dyzet e gjashtë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 828m<sup>2</sup> (tetëqind e njëzet e tetë metra katror), I JEPET në posedim Komunës Rahovec, në emër të këmbimit.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është për interes publik, ndërtimin e sheshit qendrorë të qytetit dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.
3. OBLIGOHET Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që t'i zhvillojë procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.

09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

4. Vlerësimi i pronës komunale dhe i pronës private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.
5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar me përmbajtjen e të dhënave të pronave të këmbyerë, si dhe emrin e pronarit privat me të cilin është bërë këmbimi.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës Rahovec, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

## KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.125/23  
Më datë:30.08.2023

